

VENDIM
Nr. 217, datë 23.3.2016

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, PËR DEGËN E ARKIVIT SHETETËROR VENDOR NË VLORË, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 906, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 7008, FAKULTETI TEORIK”, ME VENDNDODHJE NË VLORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, E PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për Degën e Arkivit Shtetëror Vendor në Vlorë, të disa objekteve dhe truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 5 342 (pesë mijë e treqind e dyzet e dy) m², brenda territorit të pronës nr. 906, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik”, me vendndodhje në Vlorë, sipas planvendosjes dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t’i përdorur për administrimin, ruajtjen dhe përpunimin e fondit të Arkivit Qendror të Shtetit në Vlorë.

2. Objektet dhe truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 5 342 (pesë mijë e treqind e dyzet e dy) m², brenda territorit të pronës nr. 906, me emërtim “Reparti Ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik”, me vendndodhje në Vlorë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, të ndryshuar.

3. Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Degës së Arkivit Shtetëror Vendor në Vlorë u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e përdorimit të objekteve e të truallit të pronës, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, t’i tjetërsojnë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.


4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, drejtori i përgjithshëm i Arkivave, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Planvendosja e Rep.Usht. 7008 Fakulteti Teorik,Vlore (Prona nr.906)
"Sipërfaqja që do ti kalojë Arkivit Vlorë"

Sistemi i Koordinatave Shqiptare





Shpjeguese.

-  Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet nga Arkivi i Qarkut Vlorë =5342 m²
-  Sipërfaqja nën objekt që kërkohet nga Arkivi i Qarkut Vlorë= 918.6 m²
-  Kufi reparti

Shenim:Kjo Plan vendosje u përgatit bazuar në shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të MM, nr.1030/1 dt.15.02.2015
Për hartimin e kësaj plan vendosje u shfrytëzuan dokumentacioni teknik i marrë në Arkivin e IGJUI.
Projekti i ndarjes së pronës u përcaktua në bashkëpunim me përfaqësuesin e FA zj. Pushime KOÇAJ

Punuar Shkurt 2016


4 371
335
4 483.679

483.779

483.879


483.979

PRONA nr.906
 PLANIMETRIA E OBJEKTIT nr.3
 ISH KOMANDA KATI PËRDHE
 SIPERFAQJA 186 M2
 SHKALLA 1:200




REPUBLIKA E SHQIPËRISE MINISTRIA E MBROJTJES IGJIU	DREJTORI	N/KOL. ZYDI ALCANI	
PRONA nr.906 VLORE	VIZATOI	TOP. NIKOLL TUSHI	
DATA 15.02.2016	KONTROLLOI	TOP. RAMIZ HAXHIU	

PRONA nr.906
 PLANIMETRIA E OBJEKTIT nr.3
 ISH KOMANDA KATI PARË
 SIPERFAQJA 186 M2
 SHKALLA 1:200




REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES IGJIU	DREJTORI	N/KOL. ZYDI ALCANI
PRONA nr.906 VLORE	VIZATOI	TOP. NIKOLL TUSHI
DATA 15.02.2016	KONTROLLOI	TOP. RAMIZ HAXHIU

PRONA nr.906
PLANIMETRIA E OBJEKTIT nr.4
PALESTRA DHE KINEMAJA
SIPERFAQJA 732.6 M2
SHKALLA 1:200



R
M
F



REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E MBROJTJES IGJIU	DREJTORI	N/KOL. ZYDI ALCANI	
PRONA nr. 906 VLORE	VIZATOI	TOP. NIKOLL TUSHI	
DATA 15.02.2016	KONTROLLOI	TOP. RAMIZ HAXHIU	

